


Angazhohu Monitoro Vepru



SUPLEMENT I GAZETËS NOSITI NGA GRUPI MONITORUES I TË RINJVE
POGRADEC, MAJ 2015 ÇMIMI 20 LEKË

T'i imponohemi Pushtetit Vendor me intonacionin rinor!



BËHU EDHE TI LIDER!	faqe 2
DUHET TË NISIM ME VULLNETARIZMIN	faqe 2, 3
THËNIE PËR LIDERSHIPIN	faqe 2
ÇFARË MËSOVA UNË PËR DHUNËN	faqe 4
ROLI I GRUAS SOT	faqe 5
NDRYSHIMI FILLON NGA VETJA...	faqe 6
DHUNA NE FAMILJE	faqe 6
LIDER LIND APO BEHESH	faqe 7
LIDERSHIPI DHE PERCEPTIMI	faqe 8

**ZGJIDHNI QUITZ NË FAQEN 3 DHE MERRNI NJË DHURATË
NGA GRUPI MONITORUES**

Ne ishim vullnetarët e parë pranë shoqatës “Unë, Gruaja”. U rritëm së bashku dhe u bëmë lidera.

Sot ne jemi trajnerët e projektit: “Më shumë të rinj në Leadership nëpërmjet pjesëmarrjes qytetare”.

Shumë të rinj pogradecarë i janë bashkuar nismës sonë, për të qenë të suksesshëm në jetë, për të marrë përgjegjësi dhe sfida qytetare. Ata nesër do të jenë liderat e së ardhmes.

**Bëhu
edhe
TI
Lider!**

Apliko tani pranë shoqatës “Unë, Gruaja”, Pogradec. Telefono 08322 2140

Bëhu edhe ti Lider!

Tingëllon bukur dhe motivuese fraza “Bëhu edhe ti, Lider” atëherë kur flitet për të rinjtë, eksperiencat dhe aftësitë e tyre, ndërkohë që ato kultivohen me mënyrën dhe resurset e duhura.

Shoqata “Unë, Gruaja” ka nisur tashmë implementimin e projektit “Më shumë të rinj në Leadership nëpërmjet pjesëmarrjes qytetare”, synimi i të cilit është të kultivojë një gjeneratë, e cila është e ngushtësisht e lidhur me çështjet civile në komunitet. Si një studente e re

asokohe, e angazhuar pranë shoqatës, pata mundësinë të trajnohem pranë saj për çështje të ndryshme duke nisur nga dhuna në familje dhe deri tek monitorimi i mbledhjeve të Këshillit Bashkiak. Fatmirësisht më jepet mundësia që të jem pranë saj, jo më si një person që trajnohet, por si një trajnere e përgatitur, me një bagazh të plotësuar akademik dhe sociokulturor.

Duke qenë se duhej punuar në grup, pas lajmërimit të shpallur në median sociale, vizive dhe në mjedise të ndryshme të qytetit të Pogradecit, pranë grupit tım u afruan të rinj të mençur dhe guximtarë të cilët studiojnë në Universitetin e Korçës. Trajnimet sot kanë përfunduar dhe rezultatet e tij do t’i lexoni më poshtë, të renditura bukur dhe me argumenta për atë çfarë u tha dhe së bashku u ndje gjatë katër javëve të njëpasnjëshme të trajnimeve.

Temat ishin sa të njohura aq edhe interesante për t’u zbuluar, sepse teknikat bëjnë diferencën.



Të rinjtë u trajnuan për: Vullnetarizmin, Shoqërinë Civile, Komunikimin në Publik e Median dhe së fundmi Leadershipin, Lider lind apo bëhesh?! Lojërat dhe ushtrimet mbi këndvështrimet e ndryshme të perceptimit, “Mudrat” çlodhëse, loja me shkrepse (derisa të shuhet flaka e shkrepes duhet të thuash pse je ti lideri i grupit), “Çelësi i Suksesit”, por më interesant ishte ushtrimi sesi të flasësh para kamerave (të rinjtë nuk kishin informacion se do të vinin gazetarët e televizionit SOT7 t’i intervistonin) dhe shumë aktivitete të tjera...

Dua t’i falenderoj të rinjtë për besimin dhe kurajon që patën, pavarësisht sakrificave që kërkon rruga që të çon drejt udhëheqjes.

Dua ta mbyll me shprehjen: Liderat nuk krijojnë ndjekës, por liderë të tjerë...

Doralda Tanellari



Duhet të nisim me vullnetarizmin...

Një nga temat e trajnimit e cila spikati ishte vullnetarizmi. Shpeshherë e dëgjojmë në ditët e sotme, por fatkeqësisht shumë pak marrin iniciativa të tilla duke menduar se “nuk u takon” atyre. Megjithatë çështjet e trajtuara gjatë trajnimit ishin tepër interesante dhe efektive.

Si duhet të jetë një person për t’u bërë vullnetar? Secili nga ne mund të bëhet i tillë, mjafton dëshira e mirë dhe përkushtimi. Një vullnetar nuk pret nga puna që bën, ai tenton të bëjë mirë pa menduar për përfitimin. Të dalësh vullnetar do të thotë të japësh nga vetja; si cilësi ashtu dhe ide; si aftësi ashtu edhe kohë nga e jotja.

Çfarë përfiton një vullnetar?

Vullnetarizmi është grupimi i personave që kanë qëllimin e përbashkët, që do të thotë që në çdo grup apo komunitet mund të themelohen grupet vullnetare. Sa më i rëndësishëm të jetë qëllimi e sa më seriozisht të merret vënia në jetë e ideve apo e planeve, aq më shumë do të ecë përpara grupi, për shembull me gjetjen e sponsorave për të financuar projektet.

Shoqëria ku jetojmë sot çalon në disa aspekte, por nuk duhet të

presim gjithmonë që gjërat të marrin rrjedhën e duhur vetvetiu. Ndonjëherë duhet të hedhim hapin e parë, kur e shohim se diku ka hapësirë për ndryshim. Puna vullnetare nuk vlerësohet nga ana monetare, por është një ndër gjërat më me vlerë, që mund të investosh në jetë. Kjo sepse shpalos njëkohësisht ndjenjat humane me aftësitë që ke.

Koha na vret të gjithëve kështu që duhet të gjejmë gjëra me vlerë për luftuar me kohën. Konsiderojeni vullnetarizmin si një ndër to...

Trajnimi na dha mësim të çmuara, ku më e çmuara ishte të qenit human!

Armela Sofia



Thënie mbi leadershipin

Liderët rriten, ata nuk bëhen.

- **Peter F. Drucker**

Leadership efektiv do të thotë t’i bësh gjërat e para të parat.

Menaxhim efektiv do të thotë disiplinë, t’i zbatosh.

- **Stephen Covey**

Arti i leadershipit është të thuash “JO”, jo “PO”. Është shumë e lehtë të thuash “PO”.

- **Tony Blair**

Liderët nuk lindin, ata bëhen.

Ata bëhen ashtu si gjithçka tjetër, përmes punës së rëndë dhe ky është çmimi që duhet të paguani për ta arritur atë qëllim, apo çfarëdolloj qëllimi tjetër.

- **Vince Lombardi**

E vetmja anije e sigurt në një stuhi është leadershipi.

- **Faye Wattleton**

Kur flasim për vullnetarizmin

Shoqëria civile dhe vullnetarizmi, sipas perceptimeve të ndryshme të njerëzve dhe shoqërisë'

Trajnimi më ofroi mundësinë për të trajtuar çështje nga më të ndryshmet madje jetike për shoqërinë tonë. Eksperienca e fituar do më shërbejë në formimin tim profesional dhe human.

Duke filluar nga viti 1990 e deri më sot vullnetarizmi është përhapur pothuajse në të gjithë vendin tonë. Jo vetëm të rinjtë, por edhe grup- moshat e tjera janë pjesë e vullnetarizmit. Duke investuar për të tjerët, duke ndihmuar njerëzit me probleme të ndryshme, ekonomike, sociale, psikike jeta bëhet edhe më e bukur. Disa e perceptojnë vullnetarizmin si ndjesi, si nevojë për t'iu ardhur në ndihmë njerëzve, që nuk përkrahen nga institucionet shtetërore, ndërsa disa të tjerë e perceptojnë si një mënyrë përfitimi monetar ose profesional.

Në promovimin e vullnetarizmit nevojitet edhe mbështetja e mediave, sepse kështu njerëzit do të ndërgjegjësohen më shumë dhe do të bëhen më aktivë për të qenë kontribues vullnetarë. Që ta konsiderojmë vullnetarizmin si "qeveri e 2-të" duhet të kemi mbështetjen e shoqërisë civile. Shoqëria civile dhe vullnetarët duhet të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin që problemet të gjejnë zgjidhje me afate kohore shumë të



shkurtra. Por në disa raste shoqëria civile ka qenë indiferente në lidhje me disa probleme, sepse mendohet se ka patur ndikim edhe përfshirja e politikës. Ndonëse pa dashje ose për përfitim personal të drejtuesve, këto të fundit kanë bërë që problemet në vendin tonë të mos gjejnë zgjidhje. Shoqëria civile duhet të jetë e paanshme, sepse është një nga shtyllat kryesore të gjykimit të mirëqeverisjes së vendit.

Çdo qeveri nuk i informon qytetarët për vendimet që ndërmerr, sepse nuk do që të ketë debate dhe kundërshtime nga qytetarët.

Ndaj drejtuesit e shoqërive civile (OJF) duhet të jenë gjithmonë aktivë kundërt qytetarëve. Para disa muajsh në vendin tonë do të mbërrinin armët kimike, por ky informacion nuk iu

përcoll qytetarëve. Pas disa ditësh qytetarët e vendit tonë u informuan nga mediat e huaja. Shoqëria civile bëri çdo gjë të mundur, që të parandalonte ardhjen e tyre. Pas kësaj partitë politike kërkonin të përfitonin kredibilitet, por shoqëria civile tregoi se ky vend ka një shoqëri demokratike të

ndërgjegjësuar, që nuk imponohet asnjëherë nga pushtetarët, nuk fiton kredibilitet në kurriz të qytetarëve.

Por që të vlerësohet vullnetarizmi dhe shoqëria civile duhet që drejtuesit e tyre të jenë të mirëformuar nga ana profesionale dhe të mos bien preh e interesave personale. Ata duhet të kenë qëndrueshmëri për veprimet që ndërmarrin, të jenë bashkëpunues, kërkues, por jo autoritarë sepse kjo do të sjellë shkatërrimin. Aty ku drejtonë, ku bëhen frymëzues për vullnetarizëm, do të kemi shoqëri progresiste, që do të detyrojnë qeveritë të sillen me përgjegjshmëri kundërt qytetarëve të tyre. Nëqoftëse shoqëria civile do të jetë aktive të gjithë do të shohim se do të mbizotërojë besimi dhe drejtësia në qeverisje. Unë jam gati për sfidën...


Dorjan Bego



QUITZ informues

- Si quhet ministri përgjegjës për implementimin e reformës administrative-territoriale?
- Cili është numri i qarqeve që do të funksionojnë pas reformës/zgjedhjeve lokale?
- Cili është numri i bashkive që do të funksionojnë pas reformës/zgjedhjeve lokale?
- Kur nis nga puna Këshilli i Bashkisë, pas zgjedhjeve lokale?
- Sa do të jetë numri i këshilltarëve në Këshillin Bashkiak të Pogradecit?
- Sa prej kompetencave apo funksioneve të pushtetit vendor do të ndryshojnë dhe cilat janë ato?
- Si do të realizohet decentralizimi i pushtetit (kompetencave) pas implementimit të reformës/zgjedhjeve lokale?
- Si do të realizohet korrespondenca zyrtare ndërmjet njësisë të qeverisjes vendore, sipas secilës shkallë të pushtetit vendor?

Përgjigjet e sakta dërgojini me email: une_gruaja@yahoo.com, ose FB: shoqata Une, Gruaja. Fituesi shpërblehet me...



Çfarë mësova unë për dhunën tek “Unë, Gruaja”



kësaj mizorie. Kjo vjen si pasojë e një mendësie të vjetër. Ne jetojmë në një shoqëri patriarkale, ku në qendër është vetëm burri dhe gjithçka që ai thotë është e drejtë dhe askush nuk duhet të diskutojë fjalën e tij, pasi ajo konsiderohet e shtrenjtë.

Por çfarë i çon në këto ekstremitete?

Kemi dëgjuar shpesh të flitet për raste dhunimi deri në vdekje, ku të gjitha vijnë si pasojë e një mentaliteti të mbyllur, shfrytëzues dhe jo favorizues për një marrëdhënie të mirë, të barabartë e jo të njëanshme. Pranë shoqatës “Unë, Gruaja” mësova gjënë më kryesore, nëpërmjet mesazheve të cilat ajo ua përçonte të gjithëve. Me shkronja të mëdha ishte e shkruar **HeForShe**, mesazh, i cili në brendësi kishte një thirrje të fuqishme e të rëndësishme, duke thënë, se jo vetëm femrat duhet të luftojnë kundër dhunës ndaj gruas, por edhe burrat duhet të jenë pjesa më e rëndësishme e sensibilizimit të të gjithë shoqërisë për t’i thënë “Jo Dhunës”.

Endrit Kapri

Dhuna dhe pasojat e saj sjellin probleme më të mëdha sidomos kur këtë e ndërlihim me edukimin e brezave të rinj. Tek shumë prej brezave që kanë kaluar slogani i tyre i vetëm ishte “zgjidhja e problemeve bëhet vetëm nëpërmjet dhunës”. Fatkeqësisht duket sikur këtë mendësi ua kanë kaluar edhe brezave të të rinjve. Por lind pyetja: Çfarë mund të bëhet që të ndërgegjegjësohen njerëzit se dhuna nuk është zgjidhja e problemeve të secilit prej nesh?

Kjo bëhet nëpërmjet sensibilizimeve me anë të një reklame për pasojat që mund të sjellë ai veprim, për ndëshkimin ligjor që do të sjellë, por edhe se secili nga ne mund të bëhet pre e

mbyllur, shfrytëzues dhe jo favorizues për një marrëdhënie të mirë, të barabartë e jo të njëanshme. Pranë shoqatës “Unë, Gruaja” mësova gjënë më kryesore, nëpërmjet mesazheve të cilat ajo ua përçonte të gjithëve. Me shkronja të mëdha ishte e shkruar **HeForShe**, mesazh, i cili në brendësi kishte një thirrje të fuqishme e të rëndësishme, duke thënë, se jo vetëm femrat duhet të luftojnë kundër dhunës ndaj gruas, por edhe burrat duhet të jenë pjesa më e rëndësishme e sensibilizimit të të gjithë shoqërisë për t’i thënë “Jo Dhunës”.

HeforShe

Një femër të solli në jetë, një femër të rriti
Një femër të edukoi,
Një femër veten e saj sakrifikoi
Një femër derdhi lot, mbi trupin tënd
Një femër të dha lumturi, ti s’ke pse e “çmënd”

S’ke pse hedh poshtë, gjithë dashurinë e saj
S’ke pse luan me ndjenjat, ajo nuk ka faj
Ajo derdhi lot, kur mbi ty ra një problem
Ajo u lëndua me zemër, është gjithçka për ty
Këtë dua të të them

A hidhet poshtë, arsyeja e jetës?
A hidhet poshtë, dashuria e së vërtetës?
A hidhet poshtë, zemra e vetme
Që për ty rreh çdo ditë?
A hidhet poshtë, drita që të çeli sytë?
A hidhen poshtë, lotët e kristaltë?

A hidhet poshtë “NJË FEMËR”,
për të nuk mjaftojnë “FJALËT”,
Për kujdesin që ka dhe
Dashurinë në “SHPIRT”,
Për dashurinë që ne marrim
Dhe jetojmë “ÇDO DITË”,
Për lutjet e saj, që ajo bën në “ZOT”,
Për gjithçka që ne kemi,
që kur erdhëm në jetë e deri më “SOT”.

Leonard Hysenllari

Nënshkruaj
edhe
ti
heforshe.org



Roli i gruas në shoqërinë bashkëkohore...

E fillojmë jetën duke qarë, por të mbuluar me dashuri. Nuk dimë nga të shkojmë, pasi nuk dimë nga të ecim, pasi nuk mbajmë mend se në atë kohë mendonim...

Por jeta vazhdoi, ne mësuam të ecnim, në fillim me hapa të vegjël, të pasigurt dhe me një dorë që na tregonte rrugën e drejtë.

Dhe jeta vazhdoi... Mësuam të ecnim, madje dhe të vraponim, me hapa të mëdhenj, të shpejtë, të sigurt, por ndodhi dhe që u penguan, u rrëzuam, u lënduam... dhe përsëri u ngritëm për të filluar përsëri.

Çdonjëri nga ne sot vazhdon jeton, duke mos e ditur çka është jeta! Vazhdon jeton edhe kur përjeton çaste të lumtura, të vështira, zhgënjime apo padrejtësi.

Ne, jo gjithmonë e mbajmë kokën lart, shpesh gjatë udhëtimit tonë e kthejmë kokën pas, shohim atë që kemi kaluar, lëndohemi, gëzohemi dhe kuptojmë se kemi nevojë për dorën e dikurshme që na udhëhiqte.

Ne pengohemi, na pengojnë, pengojmë të tjerë... Jeta ngjan me një fushë pengesash që duhen përballuar dhe ironia e fatit është "Kush është i zoti vazhdon dhe ec përsëri" dhe jeta vazhdon...

Ne mësojmë nga pësimet tona, kuptojmë se diçka nuk mund ta kemi përjetësisht, kuptojmë se pengesat nuk janë barriera të pakalueshme. Tashmë jemi rritur, jemi dora orientuese e vetes, udhëheqëse drejt dëshirave dhe ëndrrave tona dhe jeta vazhdon përsëri.

Në organizimin social të shekullit tonë statusi i individit përcaktohet duke parë nivelin e kontributit të tij në prodhimin ekonomik. Kjo mënyrë vlerësimi bën që gratë, pjesë e shoqërisë, të nënvlerësohen dhe të mos lejohen të fitojnë status shoqëror.

Por si e shikoj unë rolin e gruas në politikë?

Shoqëria njerëzore që nga momenti që u quajt e tillë, krijoi një koncept që i vjen në ndihmë organizimit dhe funksionimit të kësaj shoqërie.

Koncepti për politikën është po aq i vjetër sa edhe lindja e shtetit. E drejta e njeriut për t' u marrë me politike lindi si domosdoshmëri, pasi tregon humanizmin dhe emancipimin njerëzor e shoqëror në konceptin global. Shkalla e emancipimit përcaktohet nga hapësira që krijon shoqëria në përfshirjen e gruas në politikë. Ashtu sikurse çdo shoqëri e ka mentalitetin e vet në lidhje me këtë fakt.

Gruaja është një forcë e madhe shoqërore, një forcë që mund të shënojë kthesa historike me lëvizjet e saj përparimtare, emancipuese e mbarëvlerore për të gjithë shoqërinë.


Përfshirja e gruas në politikën e një vendi në raportet e duhura e thyen tabunë e nënvlerësimit të pjesës femërore të popullsisë, por edhe të mendimit të gabuar se politika është "mashkullore".

Në të gjitha ato raste kur gratë kanë qenë të përfshira në politikë, rastet konfliktuale kanë qënë më të pakta dhe mundësia e zgjidhjeve në favor të shoqërisë ka qënë më e mundshme.

Pavarësisht një roli dhe ndikimi kaq të madh, gruaja vazhdon të konsiderohet si një pjesë e nënvlerësuar e shoqërisë. Ndikimet e stereotipeve gjinore, të qenit nënë, dyshimi mbi inteligjencën e tyre në punët drejtuese apo pengesa diskriminuese janë barriera të mëdha për shoqëritë moderne.

Pikërisht për këtë arsye, gratë duhet të demonstronjë me fakte, përmes talentit, urtësisë karakterizuese, përkushtimit të tyre, se janë të afta të përfshihen në politikë e t' i japin asaj një fytyrë e përmbajtje të re, me njerëzore dhe bashkëkohore.

Vilma Hafezi



HeForShe

UN Women Solidarity Movement
for Gender Equality

Një fillim i mbarë për të ardhmen tonë

Projekti "Më shumë të rinj në Leadership nëpërmjet pjesëmarrjes qytetare" më dha mundësinë që për herë të parë jo vetëm të vizitoj ambientet e shoqatës "Unë, Gruaja", por edhe të përjetoj një eksperiencë të re që bangat e shkollës kurrë nuk ma mësuam: Si të bëhesh, Lider?!

Falë këtij trajnimit pata mundësinë të diskutoj rreth çështjeve, të cilat u diskutuan gjatë trajnimeve të njëpasnjëshme, të drejtuara nga trajneria e grupit Doralda Tanellari. Për fatin tonë të mirë u bëmë pjesë edhe e fushatës "HEforSHE" e cila na dha mundësinë që përveçse të marrim njohuri edhe të japim kontributin tonë sado të vogël në lidhje me dhunën.

E vlerësoj si shumë të rëndësishme këtë eksperiencë që për mua nuk përfundon këtu, por është thjesht një fillim i mbarë për të ardhmen tonë.

Dua të veçoj se: Shoqata "Unë, Gruaja" më nxit të kontribuoj më tepër seç mund të kem kontribuar në lidhje me çështjet e dhunës dhe jo vetëm.

Enea Mici



Dhuna në familje -Të jemi afër problemit!



zbehur sadopak këtë fenomen?! Ne mund të bëjmë shumë nëse kemi vullnetin dhe dëshirën e duhur për të përmirësuar diçka, jo duke folur apo duke dhënë opinionet tona se përse ndodh ky fenomen, sepse në këtë mënyrë nuk kemi bërë asgjë. Ajo që duhet të bëjmë ne është të jemi afër këtyre problemeve. Të sensibilizojmë opinionin publik, të bashkëpunojmë me organet kompetente për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Gjatë këtij trajnimi unë personalisht, por edhe pjesa tjetër e grupit kemi mësuar shumë gjëra të cilat do na vlejné në përballje me realitetin. Problemet që i hasim çdo ditë, me ato që përballet sot shoqëria jonë, të cilat janë të shumta si në aspektin social, ekonomik etj. Një nga problemet më shqetësuese besoj se është dhuna ndaj gruas, i cili është një fenomen që po shtohet në vendin tonë, ku faktorët janë nga më të ndryshmit.

Lind pyetja: Çfarë mund të bëjmë ne për ta

Të sensibilizojmë gratë e dhunuara që të denoncojnë dhunën e ushtruar ndaj tyre dhe të gjithë së bashku të kontribuojmë për t'iu rikthyer dinjitetin që meritojnë këto qenie, pa të cilat jeta jonë nuk do të kishte kuptim. E dimë që është e vështirë në një vend si ky i yni, por të gjithë së bashku mund të arrijmë çdo gjë. Sidomos ne meshkujt, në radhë të parë duhet të ndryshojmë sjelljen dhe mendimin për femrën dhe jo ta shohim si një mjet përfitimi apo ku e di unë se çfarë, por ta shohim ashtu si ajo e meriton.



Prandaj dhe slogani është HE for SHE

Si mund ta lëndosh një femër.
Ti që e quan veten burrë.
Si mund ta thyesh një zemër.
Që nuk ngjitet më kurrë.
Si mundesh dhunë të ushtrosh,
kur ajo meriton vetëm dashuri.
Pse jetën t'ia shkatërrosh,
kur mund t'ia mbushësh me lumturi.
Të drejtat e tyre mos i mohojmë.
Sepse slogani jonë është HeforShe.
Ndaj duhet veç t'i respektojmë.
Që ta bëjmë botën portokalli.

Gledis Mucka

Ndryshimi fillon nga vetja...



trajnimi ishte se, kur dilja në rrugë mendoja në mënyrë më të qetë, kisha zgjidhje për situata të ndryshme, kisha siguri në vetvete. Edhe tani pas përfundimit të trajnimit unë jam i bindur se mund të ndryshoj diçka në vendin tonë, tani mendimet e mija janë përçarur në të gjithë shoqërinë. Po mendohem të ndryshoj mënyrën e mendimit tek personat e afërt duke i bërë ata më sensibil rreth fenomeneve shqetësuese.

Trajnimi më bëri më human, më bëri më të ndjeshëm dhe më e

trajnimi më ofroi mundësinë për të trajtuar çështje nga më të ndryshmet, madje jetike për shoqërinë tonë. Fillimisht doja të veçoja se trajnimi më ofroi një eksperiencë unike, më bëri më të ndjeshëm për fenomenin e dhunës kundër grave. Të them të drejtën, fillimisht isha skeptik për suksesin që do kishte shoqata "Unë, Gruaja", por vullneti dhe përkushtimi që vura re tek drejtueset e këtij misioni ishte mbi limitet.

Mësova se nëqoftëse duam të ndryshojmë shoqërinë duhet të ndryshojmë veten tonë, mënyrën e të sjellurit, mënyrën e zgjidhjes së konflikteve, si të ngremë zërin qytetar kundër padrejtësive. Një tjetër përfitim që mora tek

rëndësishmja është se vetëm përmes vullnetit, përkushtimit, pasionit, ne të gjithë bashkë do ndryshojmë shoqërinë shqiptare. Vetëm përmes edukimit ne do arrijmë të kemi qytetarë dinjitoze që nesër do jenë të barabartë me shoqëritë më të përparuara duke ecur krah për krah drejt progresit.

Pra falë trajnimit unë besoj, vepro, punoj për të ndryshuar fillimisht veten, por edhe të tjerët. Eksperienca e fituar do më shërbejë në formimin tim profesional dhe human, kjo eksperiencë e vyer do jetë një armë e fortë kundër padrejtësive.

Martin Cano

Të jesh aktiv në shoqëri

Çfarë e pengon një kategori të rinjsh të jenë aktivë në shoqëri?!

Unë dua ta ngre zërin për problemin e drogës dhe alkoolit...

Droga të ndryshme përdoren nga të rinjtë në ditët e sotme si pasojë e shoqërisë që e përdor atë, ose si pasojë e varësisë. Përdorimi i këtyre lëndëve është i rrezikshëm për shëndetin tonë. Droga dhe alkoli janë një dukuri që është e vështirë për t'u kuptuar, është një fenomen shumë problematik që është përhapur më së shumti si dhe krijon varësi nga përdoruesit, duke qenë në disa raste dhe vdekjeprurëse.

Përdorimi i drogës vjen si pasojë e problemeve që mund të ketë individi ose nga një shoqëri e cila është përdoruese. Përdorimi i drogës dhe alkolit siç e dimë, është një varësi dhe për pasojë sjell kundërshtim me veten. Ata bëhen të pavetëdijshëm, humbin kontrollin dhe bëhen persona pa ndërgjegje. Këto substanca janë të dëmshme dhe duhet të luftojmë kundër tyre. Ajo çfarë ne duhet të bëjmë është të promovojmë vlera dhe risi tek të rinjtë. Ato çfarë ne mësuar në trajnim të na shërbejë si një manual gjithëpërfshirje dhe aktivizmi të të rinjve në shoqëri.

Matilda Leka

Lider lind apo bëhesh?



Ti mund të jesh një lider...

Shpesh na ndodh të vihemi në dilemë për faktin e të qenit një lider por, a mund të jetë çdokush një lider dhe a e kanë të gjithë mundësinë për të qënë të tillë?

Shumë pyetje ngrihen mbi diskutimet e të qenit apo t'u bërit lider. Të gjithë njerëzit e kanë një imazh në mendjen e tyre se si është një lider. Po të pyesim dikë se kush është një lider me siguri që do të kalonte në mendje një politikan, por jo vetëm politikanët

pyetjes, lind apo bëhesh lider është: Pavarësisht profilit personal apo veçorive individuale mund të bëhesh një lider i vërtetë, por sigurisht që edhe disa karakteristika individuale janë të lindura të cilat e ndihmojnë individin për të qënë lider.

Për t'u bërë një lider i suksesshëm ndikojnë disa variabla: Personaliteti, Qëllimet, Aftësitë e tua drejtuese, Aftësi teknike, Aftësi krijuese, Aftësi organizuese, Aftësi bashkëpunuese etj. Mënyra e

janë lidera sepse liderat janë persona të cilët vijnë nga fusha të ndryshme, por e përbashkëta e tyre më e madhe është aftësia për të inspiruar njerëz. Kështu që përgjigjja e vendosjes në përdorim të këtyre aftësive do të vendoste edhe suksesin e t'u bërit lider ose jo. Elementët që ndikojnë tek një lider janë elementë që mësohen, përmirësohen gjatë jetës, mjafton të kesh përkushtimin dhe ambicien e duhur për të qënë shumë kërkues dhe kontribues, për të arritur një bashkëpunim nga të dyja anët, sepse në të kundërt gjithçka do të dështonte. Një lider mund të bëhet ai person i cili jep shumë nga vetja dhe kërkon shumë njëkohësisht. Një lider i vërtetë është gjithmonë në kërkim të përmirësimit të vetes.

Liderët mësojnë shumë nga eksperiencat dhe kritikën që të tjerët i bëjnë performancës së tij. Një lider i

mirë njih vetëm një dështim, dështimin për të mësuar nga eksperiencia. Si përfundim ajo që mund të themi është se padyshim lider bëhesh. Mjafton të shfrytëzosh mirë mundësitë që jeta të jep. Mjafton të kërkosh më shumë nga vetja dhe të tjerët rreth tyre dhe çfarë është më e rëndësishme duhet që një lider të dëgjojë dhe vlerësojë bashkëpunëtorët, vartësit dhe palët e tjera për të pasur një sukses të vërtetë në faktin e të qenit një lider.

Viola Hamolli



11 Shprehje për të kuptuar nëse "Lideri, je ti"

1. Testi i fundit i një lideri është që ai të lërë prapa tek të tjerët bindjen dhe vullnetin për të vazhduar përpara.
Walter Lippmann
2. Leadershipti është arti kur dikush tjetër bën diçka që ju doni të bëhet sepse ai dëshiron ta bëjë.
Dwight D. Eisenhower
3. Të gjesh lojtarë të mirë është e lehtë. T'i bësh ata të luajnë së bashku është pjesa më e vështirë.
Casey Stengel
4. Unë duhet të ndjek njerëzit. A nuk jam lideri i tyre?
Benjamin Disraeli
5. Esenca e vërtetë e leadershipit është se duhet të kesh vizion. Nuk mund t'u frysh trumbetave të pasigurta.
Theodore M. Hesburgh
6. Drejtuesi më i mirë është ai që ka mjaft sens sa të zgjedhë burrat më të mirë të bëjnë atë që ai do të bëjnë, dhe i vetëkufizuar sa ta ndalojë veten dhe të mos u ndërhyjë ndërkohë që ata punojnë.
Theodore Roosevelt
7. Shpikjet duhet të menaxhohen, por njerëzit duhet të drejtohen.
H. Ross Perot
8. Liderët që punojnë më me efektivitet janë ata që kurrë nuk thonë "unë". Dhe kjo jo sepse e kanë stërvitur veten të mos thonë "unë". Ata nuk mendojnë me "unë". Ata mendojnë "ne". Ata mendojnë "skadër". Ata e kuptojnë se puna e tyre është ta bëjnë skuadrën të funksionojë. Ata pranojnë përgjegjësi dhe nuk i shmangen asaj, por "ne"-ja i merr meritat. Kjo gjë krijon besim, dhe ju aftëson që puna të përfundohet.
Peter Drucker



9. Një lider apo një njeri aksioni në krizë, gjithmonë vepron në mënyrë të nënndërgjegjshme dhe pastaj mendon arsyen e veprimit të tij.
Jawaharlal Nehru
10. Leadershipti do të thotë të gjesh një paradë dhe të dalësh në krye të saj.
John Naisbitt
11. Çelësi për leadershiptin e suksesshëm sot është influenca, jo autoriteti.
Kenneth Blanchard

Lidershipi dhe perceptimi

Çfarë besoj është ajo që arrij të perceptoj...

BEFORE 6 BEERS



AFTER 6 BEERS

Çfarë arrin të perceptosh?




Çfarë arrin të perceptosh?



Zbavituni dhe zbuloni sesa kreativë jeni njëkohësisht!



Çfarë arrin të perceptosh?



Çfarë arrin të perceptosh?

Të rinjtë pjesëmarrës

Trajnere: Doralda Tanellari

1. Armela Sofia
2. Besiana Malçellari
3. Vilma Hafezi
4. Dorian Bego
5. Viola Hamolli
6. Vangjo Spirollari
7. Leonard Hysenllari
8. Kledisa Elmasllari
9. Enea Mici
10. Endrit Kapri
11. Martin Cano
12. Gledis Muçka
13. Kristi Kërthi

Projekti: Më shumë të rinj në lidership nëpërmjet pjesëmarrjes qytetare.

Ky projekt mbështetet financiarisht nga Programi i Granteve të Vogla i Komisionit për Demokraci i Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë. Mendimet dhe opinionet e shprehura në këtë material nuk paraqesin domosdoshmërisht ato të Departamentit të Shtetit.